



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 525, datë.10.11.2021**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} DHE  
VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E  
APELIT DURRËS DHE NË GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR DY POZICIONET  
E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE TË SHPALLURA ME VENDIMET  
NR.392 DHE NR. 395, DATË 07.10.2020, SI DHE PËR POZICIONIN E LIRË NË  
FUSHËN E TË DREJTËS PENALE TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.396,  
DATË 07.10.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 10.11.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, të kandidatës z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet e tij nr.392 dhe nr.395 datë 07.10.2020, si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin e tij nr.396, datë 07.10.2020,

**VËREN**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Me Vendimin nr. 392, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile ...”.*

2. Me Vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile ...”.*

3. Me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale ...”.*

4. Në të trija këto procedura të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, afati i kandidimit është përcaktuar *“deri më datë 23.10.2020”*. Vendimet respective dhe njoftimi për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 07.10.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit për të trija këto pozicione të lira ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

6. Me Vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, *“Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020”*, Këshilli ka vendosur:

*“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet ..., nr. 392, ..., nr. 395 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro; ...”.*

7. Më datë 05.11.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor 75/2019 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”*, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrori ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 10.11.2020, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo ka dorëzuar formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionin e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI). Ky i fundit, në atë kohë, nuk ka njoftuar Këshillin, sikundër i është kërkuar me Shkresën nr. 5868 prot., datë 18.11.2020, në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi nga ana e kandidates. Përkundrazi, në rastin e dërgimit të raportit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ka konfirmuar dorëzimin në afat nga kandidatja të formularit të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.11.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e gjykatave të apelit, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}.

12. Vlen të përmendet se, me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, kjo me qëllim për të ruajtur funksionalitetin e tyre, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së renditjes dhe ngritjes në detyrë të kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë

kritereve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

13. Bazuar në sa u parashtrua në pikën 12, të këtij vendimi, Këshilli, në pikën 9, të Vendimeve nr.392, nr. 395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, pra në vendimet për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira ku ka kandiduar edhe znj. {...}, përcaktoi se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, “c” dhe “ç”, të këtyre vendimeve të Këshillit, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; ... c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, që janë kriteri i *“përvojës profesionale minimale”*, i *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”* dhe i *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

14. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 627, datë 10.12.2020, vendosi:

*“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 392, nr. 395 datë 07.10.2020, dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 392, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020”.*

15. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e pasurisë dhe të figurës, në shkronjën “b”, pika 5, të Vendimeve të Këshillit nr.392, nr. 395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen ..., si më poshtë: ... b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.*

16. Për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidates, në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë ku ajo ka kandiduar, në kushtet kur ajo ishte subjekt rivlerësimi *“ex officio”* sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 84/2016 *“Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, proces ky që për atë nuk kishte përfunduar në momentin e fillimit të procedurës së verifikimit, me Shkresën nr.5868 prot., datë 18.11.2020, Këshilli i kërkoi Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidates, bazuar kjo në Vendimin 75/2019, ku përcaktohet se: *“Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. ... ”* (Kreu X, Seksioni B, pika 2).

17. Rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi mori në shqyrtim në seancë dëgjimore, më datë 24.6.2021, çështjen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit {...}, me Vendimin nr. 407, datë 25.06.2021, ka vendosur:

*“1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.*

*2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.*

*3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.”*

18. Vendimi më lart i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 24.09.2021<sup>1</sup>, pasi nuk u ankimua.

19. Pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten, Këshilli, me Shkresën nr. 5870/18 prot., datë 28.09.2021, i ka kërkuar ILDKPKI-së përfundimin dhe dërgimin e raportit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë për kandidaten znj. {...}.

20. Po në kuadër të verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe të figurës për kandidaten, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

21. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës për kandidaten {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 07.10.2021, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

22. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 07.10.2021 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.392, nr. 395 dhe nr. 396, datë 07.10.2020 ose skualifikimin e kandidates dhe përjashtimin e saj nga procedurat e ngritjes në detyrë për këto pozicione të lira në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS**

23. Në nenin 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, Vendimin 75/2019. Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të

<sup>1</sup> Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://kpk.al/znj-f...}-celami-gjyqtare-ne-gjykatene-e-rrethit-gjyqesor-berat/>

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre, sikurse më lart u parashtrua.

24. Po ashtu, në këtë akt nënligjor, parashikoi rregulla specifike edhe për gjyqtarët që kandidonin për ngritjen në detyrë, të cilët i ishin nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe ishin konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë. Kështu, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, përcaktohet se: *“1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, do t’i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar”.*

25. Sa sipër, kandidati për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sikundër edhe procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas nenit 32 të Ligjit për Statusin, kjo për periudhën pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit.

26. Sikurse u parashtrua, kandidatja i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, me Vendimin nr. 407, datë 25.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidatë u shtri për periudhën pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit.

#### **A. Për kriterin e pasurisë**

27. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32<sup>2</sup>, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, datë 25.11.2020

28. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin Raportin/Aktin e Kontrollit nr. 373/23 prot., datë 04.10.2021.

28.1 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara nga ligji për kontrollin e pasurisë dhe interesave privatë.

28.2 Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, kjo e fundit ka kryer kontroll të plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidatja {...}, për periudhën deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

---

<sup>2</sup> "2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...".



29. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

29.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgoi informacionin me Shkresën nr. 22437/1 prot., datë 01.12.2020., protokolluar në Këshill me aktin nr. 5870/8 prot., datë 03.12.2021, ku për kandidaten {...} bëhet e ditur se nuk rezulton të ketë qenë e regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

29.2 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dërgoi informacionin me Shkresën nr. 21541/1 prot., datë 15.12.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5870/9 prot., datë 16.12.2020, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

30. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidaten, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë për kandidaten.

31. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

32. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;

- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

## **B. Për kriterin e figurës**

33. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë.

34. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila në momentin e fillimit të procedurës së verifikimit nuk kishte filluar ushtrimin e funksioneve të saj, ndërsa referuar informacioneve zyrtare publike, kishte ndodhur vetëm emërimi i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit<sup>3</sup>, ndërkohë që procedura e rekrutimit të hetuesve të këtij institucioni, hapur më datë 08.09.2020, nuk ishte përmbyllur.

35. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

36. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...} u kërkua dhe administrua informacion nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, me Shkresën nr.36/24 prot., datë 04.03.2021 janë dërguar pranë Këshillit informacionet e përcjella nga prokuroritë e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë në Këshill, me Shkresën nr.2413/1 prot., datë 24.03.2021, protokolluar me aktin nr. 5870 prot., datë 29.03.2021. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezultoi se për kandidaten {...}, nuk është regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

37. Gjithashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, në kushtet kur kjo kandidate ka qenë magjistrate në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidatja i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për

---

<sup>3</sup> Me Vendimin nr.183, datë 30.07.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

37.1 Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 5870/6 prot., datë 19.11.2020, ku për kandidaten {...} është bërë me dije se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 26.04.2016;- nga struktura e posaçme ka marrë numër rendor 000223; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruar; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

38. Kandidatja nuk iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në kushtet kur ajo është e vitlindjes më të vonshme se Korrik 1977 (kandidatja është i vitlindjes 1980), sikurse rezulton nga ligji dhe përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019).

39. Ndërkohë, gjatë shqyrtimit të rezultateve të verifikimit, në mbledhjen plenare të datës 19.10.2021, pasi konstatoi se tashmë Byroja Kombëtare e Hetimit ka filluar funksionimin e saj, Këshilli vendosi kërkimin e informacionit nga ky institucion. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Byroja Kombëtare e Hetimit, me Shkresën nr. 428/1 prot., datë 01.11.2021, ndër të tjera, bëri të ditur se nuk dispononte informacion për kandidaten {...}.

40. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;

- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtoare ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë bashkëpunëtoare, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e kandidates, mbi të cilat mund të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë.

### **III. KONKLUZIONE**

41. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

42. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me Vendimet nr.392, nr.395 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 392 dhe nr. 395 datë 07.10.2020, si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Vendimi nr. 627, datë 10.12.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**